



MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 854 Prot.

Tiranë, më 19.062017

VENDIM Nr. 119, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit HEC "MATI 2" në rrjedhën e lumit Mat*, - subjekti "MATI Hydropower" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit HEC "MATI 2" në rrjedhën e lumit Mat*, - subjekti "MATI Hydropower" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., duke plotësuar përcaktimin e pikës 2 të këtij vendimi.
2. Të paraqitet nga shoqëri e licencuar në arkeologji Koncepti i kryerjes së sondazheve arkeologjike, për zonat e konsideruara me potencial të lartë arkeologjik, i cili të paraqitet në KKA e radhës. Procedura e kryerjes së sondazheve arkeologjike do të vijojë sipas përcaktimeve të vendimit të KKA të radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARDI FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al